

K. Ankimore nr. 41



ALEANCA E MAQEDONASVE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Adresa: Fshati Pustec, Bashkia Pustec, Email: macedonian.alliance2005@gmail.com Cel: 067 20 46 050

Nr__Prot

Pustec më 28.03.2023

Lënda: Kërkes për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtar të Këshillit Bashkiak në Bashkinë Pustec, Qarku Korçë nga partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europain

Drejtuar: KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE
TIRANË

Të nderuar

Më 27.03.2023 në orën 11.55 min kemi qënë në shkollën e mesme në Pustec ku është vendosur KZAZ-ja Nr.71 për Bashkinë Pustec për të dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm si dhe listën shumemërore të kandidatëve për anëtar të Këshillit Bashkiak në Bashkinë Pustec, Qarku Korçë.

Anëtarët e KZAZ-së Nr.71 kanë filluar të shqyrtojnë dokumentacionin por pas ndërhyrjeve politike kanë refuzuar pranimin e dokumentacionin të partisë Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europain dhe kanë mbajtur një proces-verbal për refuzimin e marjes së dokumentacionit.

Pasi kemi parë proces-verbalin nuk kemi qënë dakort me përbajtjen se ka mungesë dokumenatacioni si dhe për orën e shënuar në proces-verbal 00.15 min, sepse ne kemi qënë të pranishëm në objektin e shkollës ku është KZAZ-ja Pustec në orën 11.55 min si dhe kemi kërkuar në proces-vebal të theksohet se dokumentacioni është ne rregull dhe se mungonë vetëm një kartë identiti të një kandidati, kartë e cila e kemi pasur të fotografuar në telefon.

Nga ana e anëtarëve të KZAZ-së në kanë sqarur se më datë 28.03.2023 do të komunikojnë me KQZ-në për veprime të mëtejshme.

Sot nga KZAZ-ja e Pustecit në njoftuan se nga ana e KQZ-së i kanë komunikuar ti pranojnë dokumentat e partisë Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europain dhe proces-verbalit të firmoset nga të gjithë anëtarët e KZAZ-së të Pustecit por se vetëm një anëtar nuk pranon të firmos marjen e dokumentave.

Duke u gjendur para faktit të mos regjistrimit në zgjedhjet vendore të listës shumemërore të kandidatëve për anëtar të Këshillit Bashkiak në Bashkinë Pustec të partisë Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europain ju drejtohem i të pranoni kërkesën tonë dhe të shqyrtoni dokumentacionin për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtar të Këshillit Bashkiak në Bashkinë Pustec, Qarku Korçë.

Duam të theksojmë se Bashkia Pustec është bashki minoritare të banuar nga komunitet maqedonas dhe partia Aleanca e Maqedonsve për Integrimin European është e vetmja parti në Shqipëri e cila mbron interesat e komunitetit maqedonas në Shqipëri dhe mospranimi i dokumentacionit të partisë Aleanca e Maqedonsve për Integrimin European, nga ana e anëtarëve të KZAZ-së të Pustecit ka qëllime politike dhe etnike në dëm të komunitetit maqedonas.

Bashkëngjitur ju dërgojmë dokumentacionin e nevojshëm si dhe listën shumemërore të kandidatëve për anëtar të Këshillit Bashkiak në Bashkinë Pustec, Qarku Korçë nga partia Aleanca e Maqedonsve për Integrimin European.

Me konsideratë

**Kryetar i partisë
Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European
Vasil STERJOVSKI**

